



Në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 2, shkronja d) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), nenit 13, nenit 15, paragrafi 9 dhe paragrafi 20 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, me propozimin e Kryetarit të Komunës, z. Bashkim Ramosaj, pas shqyrtimit të kërkesës për përkrahjen e propozimit të qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur" që lulëkuqja të jetë simbol i viktimave të gjenocidit në Kosovë, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.12.2022, miratoi këtë:

Deklaratë

1. Kuvendi i Komunës së Deçanit përkrahë dhe mbështet idenë, respektivisht kërkesën e qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur" që lulëkuqja të jetë simbol i gjenocidit në Kosovë dhe nëpërmes kësaj deklarate Kuvendi i Komunës pajtohet duke kërkuar njëkohësisht nga institucionet shtetërore që lulëkuqja të bëhet simbol unik i përkujtimit në Kosovë.
2. Kuvendi i Komunës së Deçanit e konsideron si të qëlluar dhe tejet kreative propozimin e qendrës "Gjenocidi në Kosovë – Plagë e Hapur" që katër petalet e lulëkuqes në logon e dizajnuar paraqesin qartë katër format e akteve gjenocidiale që Serbia zbatoj në Kosovë, që janë:
 1. Vrasja,
 2. Dhuna seksuale,
 3. Spastrimi etnik,
 4. Shkatërrimi i objekteve që lidhen me përkatësinë etnike dhe identitetin shqiptar.

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

01.Nr.XV-12

Deçan, dt.29.12.2022

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ





Bazuar në Kërkesat nga Këshilli Drejtues i Shkollës në fshatin Strelc i Epërm, punëtorëve të shkollës, kërkesës së Drejtorit të shkollës, kërkesës së komunitetit të fshatit dhe shkresave tjera përcjellëse, me kërkesës e DKA-së për ndryshimin e emrit të SHFMU-së në Strelc të Epërm nga SHFMU “Bajram Curri” në SHFMU “Haki Povataj”. Në bazë të nenit 17 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr.28/2008) dhe nenit 26 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5 të datës 31.10.2019, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.102/2020 për Emërtimin dhe Riemërimi i Institucioneve Publike Edukative-Arsimore, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.29.12.2022, ep këtë:

P Ë L Q I M

Për ndryshimin e emrit të SHFMU-së në fshatin Strelc i Epërm nga SHFMU “Bajram Curri” në SHFMU “Haki Povataj”,

I.

Kuvendi i Komunës së Deçanit ep PËLQIMIN për ndryshimin e emrit të SHFMU-së në fshatin Strelc i Epërm, nga SHFMU “Bajram Curri” në SHFMU “Haki Povataj”, i cili është njëri nga tre emrat e propozuar nga shkolla dhe i Rekomanduar nga DKA.

II.


Për zhvillimin e procedurave për ndryshimin e emrit të SHFMU-së në fshatin Strelc i Epërm nga SHFMU “Bajram Curri” në SHFMU “Haki Povataj” kujdeset Drejtoria për Arsim e Komunës së Deçanit.

III.

Me këtë Pëlqim paisen: Drejtoria për Arsim, Kryetari i Komunës dhe Arhivi.

01.Nr.XV-13

Deçan,dt.29.12.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ